



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.12.2018, ora 19.00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 015, datë 20.12.2018 “Për kthimin e ligjit nr. 94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Pjerin Ndreu.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto, dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmbërëma të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Kjo mbledhje po bëhet për shkak të mbërritjes në Kuvend të dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11 015, datë 20.12.2018 “Për kthimin e ligjit nr. 94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar””.

Sipas Rregullores së Kuvendit, dekreti i Presidentit të Republikës hyn menjëherë në procedurë. Kryetari i Kuvendit ia ka përcjellë këtë dekret Komisionit për Ekonominë dhe Financat, i cili duhet të mblidhet për ta shqyrtuar këtë dekret.

Relator i komisionit për këtë akt të Presidentit të Republikës është zoti Ervin Bushati, njëri nga 2 deputetët që e ka mbuluar këtë çështje edhe gjatë diskutimit të paketës fiskale dhe që, natyrisht ka edhe përgjegjësinë maksimale në lidhje me përmbajtjen e ligjit dhe atë të dekretit.

Gjithashtu, është ftuar në këtë mbledhje zoti Arben Ahmetaj, ministër i Financave dhe Ekonomisë, i cili do të japë opinionin e qeverisë në lidhje me këtë dekret.

Fillojmë menjëherë me relatimin e zotit Bushati.

Ju njoftoj paraprakisht se me rastin e prezencës së opozitës në parlament, janë njoftuar të gjithë deputetët e opozitës që të vinin në këtë mbledhje, por ata nuk e kanë parë të arsyeshme për të qenë në këtë mbledhje.

Ia jap fjalën zotit Bushati dhe më pas, zotit ministër!

Më tej do të vijojmë, nëse ka pyetje dhe diskutime lidhur me këtë çështje.

Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati - Faleminderit!

Në radhë të parë, dua të them se në të gjitha qëndrimet që kanë ardhur nga zyra e Presidentit këto ditë, kanë qenë sipas mendimit tim, qëndrime politike, sepse të gjitha çështjet kanë qenë pjesë e diskutimeve të politizuara të kohëve të fundit.

Në këndvështrimin e këtij komisioni dhe të kësaj maxhorance zyra e Presidentit në përfundim të politikës e ka kthyer këtë çështje me të njëjtin argument si për buxhetin për studentët, edhe në këtë rast në këndvështrimin tonë ka bërë interpretime politike.

Ideja ka qenë që me uljen e dividendit, një kërkesë e ardhur prej kohësh nga komuniteti i biznesit, ne të vinim në vend një parim, që ka të bëjë me rishpërndarjen, hyrjen e këtyre parave në treg për të rritur konsumin, për të rritur investimet dhe për të stimuluar në fund ekonominë. E gjithë kjo do të jetë në të mirë të konsumatorit në mënyrë

finale dhe kapilare. Ky ka qenë një nga argumentet që mendoj se nuk mban, aq më shumë që ky është tagri i maxhorancës në qeverisje për të bërë më të mirën në orientimin e ekonomisë dhe të financave publike.

Gjithashtu, thuhet që ka pabarazi para ligjit, kur dihet që ne kemi disa shkallë të tatimit, sepse ne kemi pasur iniciativa të tilla edhe kur kemi ulur në mënyrë të ndjeshme tatim-fitimin për biznesin e vogël, ndërkohë që ky argument është paraqitur si një pabarazi përpara ligjit.

Mendoj se për sa u përket të gjitha argumenteve për kthimin e ligjit 2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar””, nuk qëndrojnë. Për më shumë, do të shpjegohet edhe ministri i Financave.

Erion Braçe – Shumë faleminderit, zoti Bushati për relatin mbi dekretin e Presidentit! Fjalën e ka zoti ministër!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Në vijim të dekretit të Presidentit “Për kthimin e ligjit nr. 94/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar””, shprehem si më poshtë:

Fillimisht po ju paraqes argumentet e dekretit për të qenë të qartë, konkretisht për të paraqitur edhe argumentet e qeverisë.

Së pari, sipas dekretit të Presidentit, neni 9 i ligjit të sipërcituar, bie në kundërshtim me parimin e kushtetues të barazisë përpara ligjit dhe me paqartsinë e përmbajtjes së tij, krijon pasiguri juridike për aplikimin e tij në praktikë.

Së dyti, në dekret thuhet se dispozita e sipërcituar (neni 9), është në kundërshtim të hapur me parashikimet e nenit 155, të Kushtetutës, i cili ndalon trajtimin fiskal preferencial me efekt prapaveprues.

Lidhur me pretendimin për cenimin e sigurisë juridike dhe atë të parimit të barazisë përpara ligjit, argumentojmë se ndërmarrja e nismës ligjore për të ndryshuar normën e tatimit të dividendit nga 15% në 8%, u ndërmor si një iniciativë, e cila jo vetëm do ulë ngarkesën fiskale të investitorëve të kapitalit, por do nxisë njëkohësisht shtimin e konsumit, ç’ka do stimulojë prodhimin dhe importet. Këtë e kemi thënë kur kaluam ligjin në komision. Parimi i sigurisë juridike, kërkon së pari, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe së dyti, vetë ligji të mos qëndrojë statik, nëse duhet t’i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë, në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi (vendimi nr. 36, datë 15.10.2007 i Gjykatës Kushtetuese). Për sa më sipër vlerësojmë se në këto kushte

ndryshimi i propozuar nuk e cenon parimin e sigurisë jutridike, por qëllimi i këtij propozimi është nxitja e shpërndarjes së dividendit të subjektet tregtare, si një kategori, e cila kontribuon në të ardhurat e buxhetit të shtetit, për t'i konvertuar më tej këto në të ardhura dhe në shërbime për të gjithë qytetarët. Propozimi për trajtim me të njëjtën normë tatimi edhe për subjektet, të cilat nuk kanë shpërndarë dividendin përpara vitit 2017, mbështetet në faktin se, referuar edhe ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme ka tagrin të vendosë, lidhur me destinimin e fitimit apo shpërndarjen e dividendit, jo vetëm një herë, por këtë të drejtë mund t'a ushtrojë sipas vullnetit të saj në çdo kohë. Kjo është fare e qartë. Nisur sa më sipër, ky trajtim nuk mund të lidhet me një afat kohor të caktuar prekluziv.

Në kushtet kur, afati i depozitimit të vendimit të asamblesë lidhet me datën e ngjarjes së rrethanës faktike dhe/ose hartimit të aktit të detyrueshëm, në këtë rast, me marrjen e vendimit nga asambleja e përgjithshme, e cila lidhet edhe me një vendimmarrje të prezumuar, pas hyrjes në fuqi të propozimeve, nuk kemi efekte prapavepruese. Dispozita ka rol sqarues për tatimpaguesit dhe për administratën tatimore, në mënyrë që të shmangen keqinterpretimet, keqkuptimet, dykuptimet, si dhe të sigurohet zbatimi i njëjtë dhe uniform i ligjit për të gjithë tatimpaguesit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësinë për abuzim me ligjin apo korrupsion të mundshëm. Kjo, pasi edhe sipas ligjit për shoqëritë tregtare, fitimi i pashpërndarë i cilitdo viti nuk është dividend (ky është dhe thelbi i nenit), përveçse kur ka një vendim të asamblesë së shoqërisë për ta shpërndarë atë. Në këtë moment, ky fitim bëhet dividend dhe tatohet sipas tarifës, që është në fuqi në momentin e pagesës.

Ndërkohë, parimi i barazisë para ligjit nënkupton trajtimin e njëjtë dhe të barabartë sipas parashikimeve të ligjit të kohës në fuqi, parim, i cili është zbatuar për tatimpaguesit, të cilët me vendim të asamblesë kanë vendosur shpërndarjen e dividendit, pra janë tatuar me 15%. Ndryshimi i propozuar do të zbatohet në rastet kur asambleja vendos përsëri të shpërndajë dividendë, pra nuk shkohet në retrospektivë për ata që kanë shpërndarë, por për ata që vendosin të shpërndajnë dividendë nëpërmjet vendimit të asambleve. Ky argumentim është në analogji edhe me ndryshimin e mëparshëm të ligjit, kur ndryshuam normën e fitimit në burim nga 10% në 15%. Të dyja nga ana e teknikës fiskale dhe ligjore kanë një paralelizëm, një analogji dhe një ngjashmëri shumë të rëndësishme.

Konkretisht, me ligjin nr. 156/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”, u ndryshua norma e tatimit në burim për dividendin nga 10% në 15%, dhe nuk u përcaktua dhe as u pretendua të zbatohet në praktikë, që fitimet e pashpërndara të viteve 2013 ose më parë, të tatoheshin me 10%, në rast se vendimi i asamblesë mbi shpërndarjen e tyre do të merrej pas hyrjes në fuqi të

ligjit të sipërcituar. Pra, sipas ligjit që përmendëm më sipër, neni 2 dhe neni 8 i tij trajtojnë të gjithë aksionerët investitorë të kapitalit me një normë tatimi mbi dividendin 8% për vitin 2019 e në vazhdim. Pra, nuk jemi në kushtet e pabarazisë fiskale, pasi në vitin 2018 për atë pjesë të fitimit që kanë shpërndarë si dividend, kanë zbatuar normën e tatimit 15%.

Ndërkohë, me hyrjen në fuqi të ligjit të sipërcituar, aksionerët apo individët, të cilët do të shpërndajnë dividend gjatë vitit 2019 e në vazhdim, do të aplikojnë një normë tatimi prej 8%.

Së treti, neni 11 i ligjit nr. 94/2018 bie ndesh me parashikimet e nenit 84, pika 3 e Kushtetutës për sa i përket afatit të hyrjes në fuqi të ligjit. Në lidhje me parashikimin e afatit të hyrjes në fuqi, neni 11, i ligjit të sipërcituar (nr. 94/2018), gjykojmë se nuk jemi në rastin e situatës për masa të jashtëzakonshme, si edhe në rast nevojë urgjence për të cilën Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë jep pëlqimin që ligji të hyjë në fuqi menjëherë, vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht. Sqarojmë se një dispozitë e tillë, sipas nenit 11 i ligjit nr. 94/2018 është parashikuar edhe për paketën e mëparshme fiskale me qëllim që kjo paketë fiskale të fillojë të zbatohet në fillim të vitit fiskal, në të njëjtën kohë që fillon edhe viti buxhetor.

Së fundi, një vlerësim dhe një analizë më të përgjithshme të kuadrit fiskal. Ky ligj sipas dekretit të Presidentit, përmbys sistemin dhe barazisë fiskale duke e kthyer atë nga progresiv në regresiv, sepse favorizon ndjeshëm shtresën më të pasur të shoqërisë. Sipas këtij ligji, kush fiton apo ka fituar më shumë, do të paguajë më pak.

Ndryshimi i paraqitur nuk e cenon aspak parimin e barazisë fiskale. Sistemi mbetet progresiv, siç e kam theksuar në disa dalje të mia publike, referuar në statistika korrekte. Në qoftë se i referohemi tatimit të mbajtur në burim të të ardhurave personale nga puna, dua ta ndaj me ju që e dini shumë mirë këtë çështje, se e kemi ndarë disa herë bashkë, por edhe me qytetarët që ndoshta janë duke na ndjekur, se në kalkulimet tona në medianen midis 300 mijë lekë të vjetra dhe 1,5 milionë lekë të vjetra, praktikisht puna tatohet me mesataren 5,5%. Ju them se ky është tatimi më i ulët i mundshëm jo vetëm në rajon, që e kastandardin 9-10% taksë e sheshtë shkatërruese, por krahasuar me të, më sillni një shembull ku 98% e të punësuarve paguajnë tatimin mbi të ardhurat personale 5,5%. Thënë kjo, sipërmarrja do të paguajë 15% tatim-fitimi dhe 8% tatim mbi dividendin. Kjo do të thotë që në krahasim me 5,5%, taksa është gati 4 herë më e lartë, për atë që pagan kapitalin.

Të mos harrojmë edhe një element tjetër, që kjo është maxhoranca, kjo është qeveria, ky është komisioni që ka pasur në themel të punës parimin: kush fiton më pak, do të paguajë më pak. Ky është rasti t'ju kujtojmë që 91% e bizneseve në Shqipëri paguajnë ose

zero ose 5% tatim. Në të njëjtën kohë, është rasti t'ju kujtojmë që ky komision, kjo maxhorancë, kjo qeveri që kanë çimentuar që 55% e të punësuarve me të ardhura të ulëta, deri në 300 mijë lekë të vjetra, të paguajnë zero taksë.

Të mos harrojmë që krahasimisht kontributi që paguan punëmarrësi krahasuar me të gjithë rajonin, është më i ulëti në rajon. Krahasimisht vendi ynë ka taksat më të ulëta në rajon dhe në disa raste me herë, jo me përqindje të vogla. Siç e theksova janë 55% e të punësuarve në Republikën e Shqipërisë paguajnë zero taksë; 91% e bizneseve paguajnë zero taksë dhe 98% e të punësuarve taksën mesatare mbi të ardhurat personale e kanë më të ulëtën në rajon, 5,5%. Të mos flasim për fashën nga 300 deri në 400 mijë lekë, që e kanë fitimin mbi të ardhurat personale vetëm 1,89%.

Ndërkohë, nga ana e teknikës fiskale, dua të theksoj se nuk amnisti, por jemi duke folur për një fitim të deklaruar. Amnistia, në konceptin fiskal, është kur ti i lejon, nëpërmjet legjislacionit (ta sqarojmë për veten tonë, për maxhorancën, për qytetarët, që na ndjekin), tatimpaguesit të nxjerrin ato që kanë evaduar dhe t'i pastrojnë nëpërmjet një ligji specifik. Pra, çfarë kanë evaduar dhe çfarë kanë fituar jashtë sistemim fiskal ti i fton që t'i fusin në sistemin fiskal. Kjo nuk është e vërtetë në këtë rast, sepse ky nuk është rasti. Ne jemi duke folur për një fitim të deklaruar, të akumuluar në kontabilitet të kompanive, në forma të ndryshme, brenda kapitalit. Për këtë arsye unë theksoj se do të vazhdojmë ta thellojmë progresivitetin që kush fiton më pak, do të paguajë më pak.

Këtë vit ju, unë, qeveria dhe maxhoranca kemi kaluar, kemi debatuar dhe më pas kemi aprovuar në parlament ulje serioze fiskale, duke filluar që nga agrobiznesi, duke vazhduar me turizmin, me rritjen e nivelit të xhiros së taksuar me 5% nga 8 milionë në 14 milionë dhe kemi zëruar një seri me taksa apo tatime direkte apo indirekte, që e bëjnë Shqipërinë, këtë e them me krenari, vendin me taksat më të ulëta në rajon.

Për këtë arsye ju kërkoj që ta rrëzojmë dekretin e Presidentit. Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit! A ka pyetje?

Po, urdhëroni, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Zoti Ministër, kur ne futëm në fuqi paketën fiskale, që tatimi mbi dividendin kaloi nga 10 në 15%, a e patëm një handikap të tillë nga Presidenti i Republikës? A patëm ndonjë kundërshtim apo ndonjë reagim, që ishte në shkelje të Kushtetutës, sepse besoj se është përdorur e njëjta logjikë?

Arben Ahmetaj – Nuk kemi pasur asnjë kundërshtim nga Presidenti me sa kujtoj unë.

Erion Braçe – Ka qenë Bujar Nishani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, Presidenti aktual në atë kohë ishte Kryetar i Kuvendit dhe besoj se e ka votuar ligjin.

Arben Ahmetaj – Patjetër që e ka votuar, por ishte dhe kryetari i një prej partive të pozitës dhe na ka mbështetur. Një nga argumentet ishte dhe ai kushtetues, të cilin sot mundohet ta kundërshtojë me dekret.

Megjithatë, unë e kuptoj se rrëzimi i dekreteve dhe kthimi mbrapsht i ligjeve është kthyer në një instrument politik dhe këtë e pranoj modestisht si pjesë e politikës, por argumentet kushtetuese dhe fiskale nuk qëndrojnë. Pra, nuk ka pasur një argument të kësaj natyre....

Arben Pëllumbi – Kemi ndjekur po të njëjtën procedurë që po ndjekim edhe tani.

Arben Ahmetaj – Ekzaktësisht është ky komision dhe është dhe është ndjekur e njëjta procedurë.

Erion Braçe – A ka ndonjë pyetje tjetër?

Kam unë një shqetësim që lidhet me këtë pjesë të dekretit, ku flitet për hyrjen në fuqi të projektligjit. Atëherë u vendos që të botohej në Fletoren Zyrtare dhe pastaj të hynte në fuqi në datën 1 janar. Rezerva që ka Presidenti, në atë që lexova unë, lidhet me faktin që botimi në Fletoren Zyrtare mund të zgjasë dhe mund ta shtyjë ligjin përtej datës 1 janar. Mos duhej të shkruhej: “Fillon efektet pas datës 1 janar”?

Arben Ahmetaj – Mund të ishte edhe kështu, të më falni, por unë nuk shikoj ndonjë pengesë zyrtare në këtë aspekt.

Erion Braçe – Që të botohet në Fletoren Zyrtare menjëherë.

Arben Ahmetaj – Ne kemi ndjekur këtë praktikë ligjore dhe parlamentare ...

Erion Braçe – Duhet të merret qeveria me këtë pjesë, që të garantojë botimin në kohë dhe hyrjen në fuqi në datë 1 janar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shqetësimi që unë kam janë ligjet e tjera, se kjo mund të ndodhë me të gjitha ligjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ato të tjerat janë dekretuar nga Presidenti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Një pyetje kam, kur i mbaron Presidenti?

Nivini Lekaj – Me datën 25.

Arben Ahmetaj – Kjo do të thotë që ne kemi mundësi që midis datave 26, 27 dhe 28, unë do të merrem vetë, por edhe me ndihmën tuaj, që të botohen në Fletoren Zyrtare.

Erion Braçe – Shqetësimi që kam lidhet me mbylljen e punimeve të Kuvendit, nëse Presidenti i Republikës nxjerr dekret në ditët në vijim edhe për të tjerat, pikërisht për këtë hyrje në fuqi na krijohet një problem shumë i madh me paketën fiskale, sepse njerëzit janë njoftuar, janë bërë gati dhe mezi presin, sepse janë një seri masash të tjera dhe jo këto, që lidhen me një gamë shumë të gjerë jo vetëm sipërmarrjesh, por me një gamë shumë të gjerë shtresash sociale që përfitojnë drejtpërdrejt nga ulja e taksave, nga paketa fiskle dhe ky është... Ky është shqetësimi.

Arben Ahmetaj – Kryetar, ky ka qenë edhe shqetësimi im kur dëgjova që Presidenti ktheu buxhetin në Kuvend, sepse që më 1 janar duhet të fillojë bonusi i bebeve dhe unë nuk mendoj kurrë që Presidenti është kundër bonusit të bebeve; në të njëjtën, fillojnë edhe investime serioze dhe unë nuk mendoj kurrë që Presidenti do të ishte kundër investimeve serioze; në të njëjtën kohë fillon edhe rritja e pagave dhe nuk besoj se Presidenti është kundër rritjes së pagave të mjekëve, infermierëve apo të mësuesve.

Erion Braçe – Zoti Ministër, jemi të ky dekret.

Anastas Angjeli – Të flasim për këtë se si ta zgjidhim. Është e sigurt?

Erion Braçe – Më fal, Anastas, jemi të ky dekret. Presidenti ka argumentet e tij. Një pjesë të shqetësimeve që ai ka ngritur, kanë qenë çështje edhe të diskutimit në komision, të them të drejtën, kështu që të merremi me këtë gjë. Pjesa e buxhetit merr përgjigje pas disa minutash. Ndjekja e këtij precedenti mund të krijojë shqetësim për ligjet e tjera fiskale. Kjo më shqetëson mua. Nuk më shqetëson gjë tjetër.

A ka ndonjë pyetje tjetër? A ka diskutime? Nuk ka.

Për të mbyllur, po flas individualisht dhe jo në cilësinë e drejtuesit të këtij komisioni, sepse besoj se të gjithë keni mendimin tuaj. Është e vërtetë që argumente kushtetuese, në referencë të asaj që Kushtetuta i jep si tagër dhe si atribut Presidentit të Republikës, edhe unë nuk gjej. Për më tepër që edhe këtë e konsideroj një akt politik, njësoj si për buxhetin e shtetit, që ishte përsëri një akt tjetër politik, i cili mund të ishte zgjidhur farë lehtësisht duke u konsultuar me ministrin, me komisionin etj. Natyrisht që ky është një proces kompleks. Ju thashë që komisionit i është dashur një muaj kohë, mbase pak më shumë se një muaj, relatorëve akoma më shumë për të diskutuar, për të marre opinionin e ekspertëve, të qeverisë, të ekspertëve të tjerë të pavarur dhe ka dëgjuar dhoma tregtie e grupe interesi dhe e gjitha kjo nuk mund të hidhet tutje me një argumentim të shpejtë, të thjeshtë apo duke u njohur thjesht e vetëm me protokollet apo me procesverbalet e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Komisioni është i lirë, ka pasur opinionet e tij, nga unë i pari deri te më i fundit, që i kanë vlejtur ose jo diskutimit që është bërë për këtë çështje. Unë mendoj se gjërat, para se të

shkojnë në këtë pikë mund të ishin diskutuar fare mirë, sepse të gjithë kemi interes. Në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” janë marrë edhe masa të tjera: është masa e pagave, që shkon për një shtresë, të cilën e konsiderojmë pjesa e sipërme e shtresës së mesme, që duhet ta përfitojë atë favor që i kemi dhënë, janë edhe masa të tjera, prandaj është në interesin e të gjithëve që të hyjë në fuqi.

Pra, edhe një herë, unë nuk shikoj argument kushtetues, me sa Presidenti ka sjellë këtu. Por, nga ana tjetër, zoti Ministër, unë po insistoј përsëri në atë pikë që kam insistuar edhe në komision, mbase, për njohuritë e mia, për bindjen time, qoftë kjo edhe ideologjike, natyrisht unë nuk e mbështes, ashtu siç nuk e kam mbështetur edhe në komision, uljen e dividendit. Por, po e theksoј edhe një herë tjetër, ky dekret nuk ka arsye kushtetuese për t’u sjellë këtu. Çështja është një diskutim i pastër ideologjik, mund ta bëjmë me cilindo, mund ta bëjmë edhe me Presidentin e Republikës, në cilësitë e tij apo në formimin e tij politik apo ideologjik e të tjera me radhë. Por për këtë që jemi mbledhur, për argument kushtetues, më vjen keq, por nuk ka. Argumentet politike t’i lëmë jashtë kësaj salle komisioni ose të bëheshin atëherë kur u diskutua projektligji në parim, nen për nen dhe shkoi deri në fund.

A ka ndonjë gjë tjetër? Nuk ka.

Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro dekretit të Presidentit të Republikës? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Dekreti rrëzohet.

Edhe një herë dua t’u shpjegoј medieve për urgjencën, ajo lidhet me interesin publik, në këtë rast shqyrtimin, dhe me interesin tjetër, që nesër është seanca e fundit e Kuvendit për këtë sesion, dhe natyrisht ne duhet t’i jepnim përgjigje kësaj çështjeje jo thjesht për punën e dividendës, se sa për pjesën e masave të tjera fiskale që ka një shtrirje akoma më të gjerë se sa ajo. Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti